

PROCESVERBAL 6/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 6 (gjashtë) për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 27.06.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e rregullores 01-Nr-209;
4. Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;

Kryesuesi - çdo vit Komuna e Suharekës miraton një projekt-vendim të tillë e cila ka të bëjë për bonus banimin për familjet në nevojë. Janë shtatë familje përfituese të qerasë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e rregullores 01-Nr-209;

Kryesuesi - ky projekt-vendim përmban tre nene me të cilat shfuqizohet tërësisht rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "13 Qershori" në Suharekë.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - sa i përket bonus banimit, a është mundësia me i ndihmu një personi? Tokën e ka ble.

Doruntina Zenelaj - sa e di unë, nëse ka tokë në emër të vetin nuk mund të merr bonus banim.

Denis Sofra - bonus banimi ka të bëjë për familjet të cilat janë për momentin në banesë por nuk mund të paguajnë qera.

Doruntina Zenelaj - këtu hynë kategoria e nënave vetushqyese,familjet me raste sociale,që kanë sipërfaqe të banimit nën normat e banimit etj.

Kryesuesi - sa i përket menaxhimit të faqes së Komunës,unë nuk kam mundur të gjej në faqe të Komunës asnjë komitet që Komuna ka,siç janë KPF-ja dhe Komiteti për Komunitetet si dhe emrat e anëtarëve dhe të Kryesuesëve.

Reshat Reshitaj - unë jam udhëheqës i zyrës për komunikim me publikun dhe janë dy IT.Ata i fusin të dhënat dhe normalisht unë e menaxhoj. Këto vërejtje unë do ti marrë parasysh dhe do ta verifikoj por besoj që janë sepse çdo procesverbal,çdo takim publikohet.

Kryesuesi - kam pas një takim me asociacionin e Komunave dhe zyrtari që ka planifiku takimin më tha që nuk ka mundur të gjej asnjë anëtar të KK-së dhe as të KPF-së në faqen e Komunës.A është mundësia që në faqen e Komunë të futen dy komitetet,të gjithë emrat e anëtarëve ,Kryesuesëve dhe numrat kontaktues.

Reshat Reshitaj - pas verifikimit të faqes thotë që nga 2020-ta nuk janë këto dy komitete në faqe. Kërkon adresat e anëtarëve dhe thotë që do ti vendos në web faqe.

Takimi përfundoi: 09:15